

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Agim Ademi kryetar i trupit, dhe gjyqtarëve Ramiz Azizi dhe Luljete Shabani anëtarëve të trupit gjykues, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit P. R nga fshati LI, Komuna e F, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati, për shkak të veprës penale rrëmbimi i personit në tentativë, nga neni 194 paragrafi 1, lidhur me nenin 28 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I. nr. 122/14, të datës 22.07.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datë 06.04.2017, publikisht shpalli këtë::

A K T G J Y K I M

I akuzuari P. R nga i ati I dhe nëna N. e lindur M, i lindur më datë , në F me vendbanim të përhershëm në fshatin LI, Komuna e F, i pa martuar, i pa punësuar, ka të kryer shkollën e mesme teknike drejtimi i makinerisë, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datë 29.03.2014, rreth orës 23,30 minuta në rrugën e ...ka tentuar ta rrëmbej të dëmtuarën ish bashkëshorten e tij N. R nga fshati K, në atë mënyrë që përderisa e njëjta ka qenë duke ecë rrugës i akuzuari P. R. fillimisht e ka përcjellë nga pas me automjetin e markës “..” me ngjyrë të .., me tabela të regjistrimit të dhe me atë rast ka dalë nga vetura dhe e ka kap me forcë për krahu duke tentua ta fusë në veturë, ndërkohë që me intervenimin e babait të dëmtuarës I.R detyrohet ta lëshojë të dëmtuarën dhe ikë në drejtim të F. dhe vepra i mbetet në tentativë.

Me çka ka kryer veprën penale, rrëmbim i personit nga neni 194. par.1. lidhur me nenin 28 të KPRK-ës.

Andaj, bazuar në nenet 7, 17, 41, 45, 73,75,76, 114. të KPPRK dhe nenit 365, 453, të KPRK-ës.

E G J Y K O N

I. Të akuzuarin P. R, me dënim burgu në kohëzgjatje prej 8. (tetë) muaj, të cilin dënim i akuzuari do ta mbaj në afat 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës e gjithë këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzë PP.nr.122/2014, të datës 22.07.2014, kundër të akuzuarit P. R nga fshati LI, Komuna e F, për shkak të veprës penale, rrëmbim i personit në tentativë, nga neni 194 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda Afrim Shefkiu, në fjalën përfundimtare theksoi se mbetem në tërësi pranë aktit akuzues pasi që pas mbajtjes së seancave gjyqësore është vërtetuar se i akuzuari P. R e ka kryer veprën penale "rrëmbimi i personit në tentativë", ngase kjo është vërtetuar nga përshkrimi i veprimeve inkriminuese të akuzuarit nga e dëmtuara N. R., e cila në mënyrë bindëse ka dëshmuar se mbrëmjen kritike i akuzuari ka tentuar që ta fus në veturë në afërsi të "... "market në Gjilan duke e kapur për krahu . Po ashtu edhe nga deklaratat e dëshmitarit I.R janë përshkruar veprimet inkriminuese të akuzuarit ku deklaroi se i akuzuari Përparim në veturën e tipi "Golf II" e ka vërejtur se i akuzuari e ka kapur me forcë për krahu të dëmtuarën por që pas intervenimit të tij dhe të R. R. vepra ka mbetur në tentativë . Edhe provat materiale të administruara si raporti i incidentit por edhe akti përcjellës nga stacioni policor në Gjilan vërtetojnë kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, e që përputhet me deklaratat e dëshmitareve të lartë përmendur . Po ashtu deklarata e të akuzuarit të dhënë në tërësi dallon nga ajo e dhënë në shqyrtimin gjyqësor. Andaj propozojë trupit gjykues që të akuzuarin P. R. ta shpallë fajtor dhe ta dënoje me dënim meritorë sipas kodit penal KPRK.

E dëmtuara N. R deklaroj se lidhur me atë se a i bashkëngjitëm ndjekjes penale vendos Gjykata ndërsa nuk ushtroj kërkesë pasurore juridike, derisa në cilësinë e dëshmitares shtoj se dy jave para ngjarjes kritike unë kam punuar tek “ ..“ market i cili gjendet në rrugën qarkore në Gj afër “” dhe aty pas dy ditë që kam filluar punën ka ardhur i akuzuari me veturën e tij “diku rreth orës 7 të mëngjesit dhe më ka marrë dhe më ka dërguar në F por jo në shtëpinë e tij dhe më është lutur që të kthehem pasi që më parë kishim jetuar bashkë për rreth 5 muaj. Me pas kemi shkuar ne shtëpinë e tij dhe vëllezërit e P kane thënë se çka ke bërë që unë jam kthyer që unë te nesërmen rastin e kam paraqitur ne stacionin policor ne F . Natën kritike derisa kam qene te vajza e xhaxhait e cila jeton afër “” market ne G dhe babai im se bashku me nenën dhe vëllain kane ardhur që te me marrin diku rreth orës 23:00 pas që kishin dalë me prindërit për të shkuar në shtëpi e me të arritur te pompa e benzinës e cila gjendet në rrugën e F , vajza e xhaxhait H e ka ftuar babanë dhe i ka thënë që le të rrijë N edhe sonte ashtu që pasi unë i kam thënë babait po rri , kam zbritur nga vetura dhe jam kthyer mbrapa , në anën e kundërt një veture e tipit “me regjistrim 05 te cilën ishte duke e vozitur i akuzuari , i njëjti e ka ndal veturën dhe më ka kapur për krahun e djathtë dhe ka dashtë të më fusë në veturë . Kam qenë e frikësuar dhe kam bërëtitur ashtu që ka ardhur babai ashtu që kur babi e ka ndalë veturën i cili me kishte vërejtur , i akuzuari me veturë ka ikë nga vendi i ngjarjes.

Dëshmitari I.R deklaroi se mbrëmjen kritike derisa kemi qenë tek vajza e vëllait H me bashkëshorten dhe djalin tim si dhe me N jemi nisur me veturë për në shtëpi . Pas nja 100 metrash më ka ftuar vajza e vëllait me telefon dhe më ka thënë që le të rrijë Na dhe të nesërmen vijmë bashkë . Pasi që e njëjta më ka lutur e kam lejuar N te qëndrojë edhe një natë dhe e njëjta ka zbritur nga vetura është nisur në drejtim të banesës së H. Unë kam vazhduar me veturë dhe në ato momente më ka tejkaluar nga drejtimi i qytetit dhe te pompa e benzinës “IP Petrol” përsëri është kthyer ne drejtim te Gjilanit . Unë jam kthyer me veturë pasi që kam dyshuar se mund ti ndodhe diçka vajzës ashtu që jam nisur ne drejtim te qytetit dhe kam vërejtur veturën e të akuzuarit ne një distance prej 5-6 metra si dhe te akuzuarin i cili ishte duke e tërhequr vajzën për krahun , ashtu që kam bërëtitur dhe duke i thënë lëshojë vajzën , ndoshta edhe ka fyer diçka ashtu që i akuzuari e ka lëshu vajzën , ka hy në veturë dhe është larguar në drejtim të F.

Dëshmitarja B. R mbrëmjen kritike kemi qëndruar tek vajza e kunatit me bashkëshortin dhe djalin dhe derisa aty më parë ka qenë vajza N diku rreth orës 23:00 në mbrëmje kemi dalë nga aty dhe me veturë jemi nisur për në shtëpi dhe me të arritur afër “ vajza e kunatit e ka thirrur bashkëshortin tim dhe ka kërkuar që ta lë edhe një natë N tek ajo , ashtu që e kemi ndalur veturën dhe N ka zbritur nga vetura dhe është nisur në drejtim te banesës ku ishim më parë . Me të arritur te pompa e benzinës, bashkëshorti e ka kthyer veturën në drejtim të qytetit ngase e kishte vërejtur P. Jemi kthyer te poshtë me ç ‘rast e kam parë P duke tentuar me fut në veturë vajzën time N . Dyert e veturës i ka pas te hapur e që pastaj bashkëshorti ka vrapuar në drejtim te vajzës dhe Pka ikur me veturë në drejtim te F. Vajza në ato momente ishte e shqetësuar, ashtu që rastin e kemi paraqitur në polici .

Dëshmitari R.R.deklaron se e di që P ka qenë në martesë me të dëmtuarin N Rexhepi dhe fillimisht ka pas probleme me prindërit e të dëmtuarës N , derisa raportet mes Përparimit dhe N, ketë e di ngase i kemi shtëpitë afër. Pas një periudhe kohore prej 4-5 muajve familja e të dëmtuarës kanë kërkuar që e njëjta të ndahet nga i akuzuari . Pas angazhimeve për tu bashkuar që i kam ndërmarre unë dhe daja i të dëmtuarës , e dëmtuara është kthyer te Përparimi dhe pas një jave si rezultat i presioneve te familjareve të dëmtuarës e njëjta është larguar dhe sipas njohurive të mija P. më tutje nuk ka shprehë interesim për te dëmtuarin pasi që ai vet më ka treguar . Unë në fshat kam një restorant “ Italia” në të cilin Pka frekuentuar zakonisht në mëngjes për të pirë kafe e edhe ashtu në mbrëmje prej orës 21:00 vine te afërmit për të luajtur lojëra të ndryshme dhe P. zakonisht ka qëndruar deri në fund të orarit të punës por saktësisht nuk e di , por sa i përket mbrëmjes kritike i njëjti ka qëndruar aty deri rreth orës 21:00 dhe lidhur me rastin Përparimi më ka thënë se po më kërkojnë policia .

Mbrojtësi i te akuzuarit avokat deklaron se pas mbajtjes së seancave gjyqësore nuk është vërtetuar se i akuzuari ta ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet , ngase bazuar në faktin se të gjithë dëshmitaret edhe vet e dëmtuara nuk ishin bindes aq më tepër kontradiktore me njëra tjetrën si dhe për fakti se e dëmtuara pas ndarjes me te akuzuarin dhe raporteve jo te mira në mes tyre si dhe gjendja shëndetësore e të dëmtuarit si dhe e njëjta është paraqitur me emra te ndryshëm (të rremë). I akuzuari ka deklaruar se pas ndarjes definitive me te dëmtuarën N nuk ka pasur kurrfarë interesi për tu takuar me të ngase nuk ka ekzistuar vullneti për të u ribashkuar . Po ashtu është jo bindëse deklarata e të dëmtuarës pasi që e njëjta jep deklaratë kontradiktore ato qe ka dhënë ne polici . Po të ishte e vërtetë ngjarja afër “ “ market , bizneset kanë kamera sigurie ashtu që qdo lëvizje në afërsi të tyre do të regjistrohej . Po ashtu edhe dëshmitari R .R.deklaroj se i akuzuari P çdo natë ka qëndruar ne restorantin e tij. Andaj duke qenë se aktakuza është e pa bazuar Gjykata të nxjerrë Aktgjykim lirues bazuar ne nenin 364 paragrafi 1 nen paragrafi 3. të KPPRK-së.

I akuzuari P. R deklaroj se ne mbrojtjen e tij se me të dëmtuarën kemi krijuar lidhje jashtë martesore në vitin 2013 dhe për 5 muaj kemi jetuar bashkë . Fillimisht raportet kane qenë te mira por pas një kohe raportet janë çrregulluar dhe jemi ndarë ashtu qe te ndare kemi qëndruar 2 – 3 muaj . Pas kësaj kohe e njëjta ka shprehur përsëri vullnetin për tu bashkuar me ndërmjetësimin e dajës se saj dhe fqinjit tim , por që e njëjta ka kërkuar që unë të ndahem nga familja dhe të jetojmë në një banesë vetëm me të . Një kohë përsëri raportet kanë qenë të mira e pas 2 – 3 ditë pastaj pa e pyetur askënd e njëjta ka shkuar tek familja e saj ashtu që më nuk kam shprehur interesim për të por qe e njëjta disa herë me ka kërkuar ne S . Me datë 29.03.2014 unë nuk kam qenë fare ne G, por qe kam qenë tërë ditën tek fqinji im te restorant ” andaj as qe kam mundur të shohë te dëmtuarën e as familjen e saj . Në atë kohë unë kam pasur një veturë të tipit “e po ashtu vlen të ceket se N ka pasur edhe një emër tjetër përkatësisht ka thënë se e quajnë Ne G as ndarjes me të dëmtuarën kam qenë pasi që kam marrë bileta udhëtimi në kompaninë “ “. Andaj duke e përkrahur fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim kërkojë nga trupi gjykues që të më liroj nga përgjegjësia penale .

Gjykata bëri leximin dhe analizimin e provave materiale edhe atë raportin fillestare mbi incidentin te date 30.03.2014 dhe aktit përcjellës te datë 29.03.2014 hartuar nga policia e Kosovës , stacioni policor ne Gjilan.

Nga provat e shtjelluara në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimin e tyre veç e veç, si dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-ës Gjykata konstatoi këtë gjendje faktike, se i akuzuari dhe e dëmtuara N. R kanë qenë në bashkësi jashtëmartesore për diku 5 – 6 muaj por për shkak te çrregullimit të raporteve ishin ndarë por që me intervenimin e njerëzve përsëri ishin bashkuar ku së bashku kanë jetuar edhe për 1 jave e me pas përsëri janë ndarë. Ditën kritike me datë minuta derisa e dëmtuara N.R kishte qëndruar tek vajza e xhaxhait H dhe kishin ardhur për ta marrë te dëmtuarën prindërit e saj si dhe vëllai , ashtu qe pasi qe ishin nisur me veturë për tu kthyer ne shtëpinë e tyre babain e te dëmtuarës I e kishte ftuar me telefon H dhe e kishte lutur N te qëndroje edhe një nate ne mënyre qe te nesërmen te shkojnë bashke ne shtëpinë e N . Babai i N s i kishte dhëne leje N për te qëndruar edhe një nate ashtu qe N kishte zbritur nga vetura dhe ishte nisur ne drejtim te banesës ku ishin me parë . Në ato momente me veture i akuzuari P. R e veturën e tipit “Golf II” i cili ishte duke qarkulluar nga qyteti për ne drejtim te Ft me te vërejtur te dëmtuarin është kthyer me veturë e pasi që e kishte pare P babai te dëmtuarës ishte kthyer me veturën e tij ne drejtim te qytetit . Pasi që i akuzuari P ishte kthyer në drejtim te qytetit përballe “...” market e ka ndalur veturën e ka hapur derën e përparme te veturës , e ka kapur për krahu duke tentuar qe ta fus ne veturë dhe pasi që e dëmtuara kishte rezistuar - bërëtitur dhe në ato momente arrin babai te dëmtuarës tani dëshmitari I. R duke i thënë “ lëshoje vajzën “, i akuzuari me veturë ikë në drejtim te F dhe vepra mbetet ne tentativë .

Me rastin e konstatimit të gjendjes faktike ju fal besimi provave materiale edhe ate: raportin policor lidhur me kohën dhe vendin kryerjes se veprës penale. Ju falë besimi dëshmisë së dëshmitareve I.R dhe B R. lidhur me vendin, kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale pasi qe te njëjtit ishin dëshmitar okular te ngjarjes , duke e përshkruar se si i akuzuari e kishte kapur për krahu te dëmtuarën se vetura ishte e ndezur dhe dyert e hapura duke i tentuar ta fuste ne veturë. Ju falë besimi edhe dëshmisë së dëmtuarës N. R në cilësi te dëshmitares pasi që dëshmia e saj ishte bindëse, duke e përshkruar mënyrën dhe veprimet inkriminuese të te akuzuarit P. R dhe se dëshmia e saj ishte në harmoni me provat tjera në veçanti me dëshminë e dëshmitareve. Po ashtu u vlerësua edhe deklarata e dëshmitarit lidhur me faktin se paraprakisht e dëmtuara dhe i akuzuari kanë qenë në bashkësi jashtë martesore e me pas ishin ndarë e edhe ribashkuar por sa i përket mbrëmjes kritike dëshmia e tij nuk ishte bindëse për të provuar “ë” e të akuzuarit por vetëm se ka theksuar se i akuzuari zakonisht ka qëndruar në lokalën e tij deri në përfundimin e orarit të punës.

Nga një gjendje e këtillë e konstatuar faktike, në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale rrëmbim i personit nga neni 194 par.1. lidhur me nenin 28 të KPPRK-ës, për çka Gjykata e ka shpallur fajtor dhe penalisht përgjegjës dhe e ka dënuar me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara konform nenit 73 të KPK-së. Si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari pati sjellje të mira në Gjykatë dhe faktin se pas asaj kohe nuk kanë pasur asnjë problem me të dëmtuarën. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh mënyrën e kryerjes të veprës penale dhe vendosmërinë për ta kryer veprën . Në prezencë të këtyre rrethanave dhe për faktin se vepra penale kishte ngelur në tentative gjykata në zbatim të dispozitave për zbutjen e dënimit nga neni 75 dhe 76 të KPPK-së, të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se edhe ky dënim do të ndikoi pozitivisht tek i akuzuari dhe do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41. të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është i bazuar në nenin 453, të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 160/2014 Me datë. 06.04.2017

Sekretare juridike
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.*